



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMI
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENT" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 399/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: Vedat Poterqoi- Kryetar, Nita Bejta – Anëtare, Agon Ramadani – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "Menti sh.p.k & ENGINEERING Group Sh.p.k" Istog, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Sadri dhe Adem Osaj (Gushavcit)", me nr. të prokurimit: 631-22-6688-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna Deçan, me datën 13.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa e operatorit ekonomik "Menti sh.p.k & ENGINEERING Group Sh.p.k" Istog, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 29.08.2022 me numër protokolli 399/2022 për aktivitetin e prokurimit lidhur me tenderin: "Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Sadri dhe Adem Osaj (Gushavcit)", me nr. të prokurimit: 631-22-6688-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna Deçan.
- II. Mbetet në fuqi, njoftimi për dhënie të kontratës të aktivitetit të prokurimit "Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Sadri dhe Adem Osaj (Gushavcit)", me nr. të prokurimit: 631-22-6688-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna Deçan.
- III. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues të OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, të precizuar me numër dhe datë si në paragrafët paraprak të dispozitivit të këtij vendimi.

- IV. OSHP mund të ndërmarr masa ndaj AK për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092.
- V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Menti sh.p.k & ENGINEERING Group Sh.p.k” Istog, është e pa bazuar, bëhet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës konform nenit 31 par 5 të Rregullores së Punës së OSHP-së 01/2020.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 05.07.2022, Komuna e Deçanit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për kontratë të aktivitetit të prokurimit “Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Sadri dhe Adem Osaj (Gushavcit)”, me nr. të prokurimit: 631-22-6688-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna Deçan. AK me datën 10 gusht 2022 ka ngarkuar në sistemin e e-prokurimit vendimin për dhënie të kontratës GOE “Lika Company Sh.p.k; Lika trade Sh.p.k”. Kundër këtij vendimi OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK me datën 15.08.2022 ndërkaq AK me datën 18.08.2022 ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim.

OE ankues kundër këtij vendimi ka parashtruar ankesë në OSHP me datën 29 gusht 2022.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave -

OSHP ka angazhuar ekspertin shqyrtues të prokurimit që në pajtim me nenin 113 të LPP-së, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore. Eksperti shqyrtues ka dorëzuar raportin e ekspertizës me 09.09.2022, duke sqaruar që:

Përgjigje në Pretendimin ankimor I

OE ankues i pa kënaqur me vendimin e AK-së lidhur me arsyen e tij të eliminimit pretendon se AK-ja ka shkelur dispozitat ligjore të LPP-së si Nenin 1,6,7,59,60,72 si dhe Nenin 39 dhe 41 të RRUOPP-së. OE ankues pretendon se AK-ja e ka eliminuar nga gara për arsye të çuditshme, dhe nëse do të kishte paqartësi AK-ja ka mundur të kërkojë sqarime. OE ankues thekson se diskriminimi ka ndodh në momentin që një OE ka ofruar çmimin më të lartë për njësi. Andaj ka ndodh një gabim aritmetikor që nuk e kalon 2% të vlerës dhe është një devijim i vogël.

Pas analizimit të dokumentacionit të ofruar në E prokurim për këtë aktivitet të prokurimit, eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues është eliminuar me arsyen se:

Grup i Operatorëve Ekonomik „Menti Sh.p.k.; Engineering Group SH.P.K.” është në kundërshtim me kushtet e dosjes së tenderit përkatësisht: pika 20.3 Në qoftë se tenderët janë ftuar për kontratat individuale (lot-e) çmimet e ofruara duhet të korrespondojnë me 100% të artikujve të specifikuar për secilën pjesë (lot) dhe 100% për sasi të specifikuar për secilin pozicion për atë pjesë (lot). ku ne rastin në fjalë komisioni i vlerimit ka hasur në ndërhyrje nga ana e Grup i Operatorëve Ekonomik „Menti Sh.p.k.; Engineering Group SH.P.K.” te pozicioni 1.6.12 të paramasës dhe parallogarisë. Andaj eliminohet nga konkurrenca

Eksperti shqyrtues, sqaron se pozicioni 1.6.12 i para masës së publikuar nga AK-ja, sasia e kërkuar për këtë pozicion është 34 528.00, ku njësia matëse është KG, ndërsa OE ankues për këtë pozicion në paramasën e tij ka ofruar 34 258.00.

Nga përshkrimi i dhënë kuptohet që sasia e kërkuar për këtë pozicion nga ajo e ofruar nga OE ankues nuk është e njëjte, nuk është konform kërkesës së AK-së.

Eksperti shqyrtues, sqaron se Para masa e ofruar nga autoriteti kontraktues nuk lejohet të preken njësia matëse dhe sasi të kërkuar, plotësohet vetëm pjesa e çmimit të ofruar nga ata, pastaj formula e bënë llogaritjen totale të çmimit të ofruar me sasi të kërkuar nga AK-ja.

Lista e çmimeve e kërkuar nga autoriteti kontraktues përbehet prej Fushave të mbyllura dhe fushat e hapura. Fushat e mbyllura janë Pozicioni, Njësia, Sasia dhe këto fusha nuk lejohet të ndërhyjnë nga operatorët ekonomik, ndërsa fushat e hapura siç janë çmimi njësi dhe vlera totale janë fushat ku Operatorët ekonomik duhet t'i plotësojnë. Andaj është përgjegjësi e zyrtarit të prokurimit dhe njësisë kërkuuese të AK-së të hartoj apo përpiloj para masën dhe para llogarinë dhe në bazë të asaj para masë OE duhet ti paraqesin çmimet e tyre (ofertat financiare) duke mos ndryshuar nga Para masa e AK-së.

Gjithashtu, vetëm AK-ja e din sasinë e saktë të produktit se sa i nevojitet dhe askujt nuk i lejohet të ndërhyjë në vlerat të cilat vetë AK-ja i ka prezantuar si nevoja të sajë që duhet të plotësohen. Dhe ndryshimi i këtyre kërkesave nga operatorët ekonomik në para masë nuk mund të llogaritet si gabim aritmetikor.

Andaj, eksperti shqyrtues e sheh pretendimin e OE ankues si të pa bazuar për faktin se nuk kemi të bëjmë me gabime aritmetike dhe as me devijime të vogla siç pretendon OE ankues, por kemi të bëjmë me ndërhyrje në një pozicion të para masës, konkretisht tek sasi të pozicionit 1.6.12 të para masës, pra operatorit ekonomik ankues konkretisht paramasa e ofruar nuk është ofruar sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE “Menti sh.p.k;&ENGINEERING Group Sh.p.k” Istog të refuzohet si e pa bazuar, dhe rekomandon që të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Operatori ekonomik ankues me datën 09.09.2022 ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues të prokurimit.

Autoriteti kontraktues me datën 09.09.2022 ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues të prokurimit.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 13.10.2022, pa praninë e palëve në procedurë konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, njoftimit për dhënie të kontratës, raportit të vlerësimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtrirat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi sqaron;

Paneli Shqyrtues ankesën e OE ankues e klasifikon si të pabazuar dhe e mbështetet raportin e përpiluar nga eksperti shqyrtues i prokurimit, i cili është caktuar nga OSHP, detyrë e të cilit ka qenë që të shqyrtohen të gjitha pretendimet ankimore dhe propozimi i tij për panelin shqyrtues është që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar, dhe në përputhje me LPP-në, rekomandon që të mbetet në fuqi vendimi i autoritetit kontraktues. Kështu që, edhe arsyetimet e dhëna nga ekspertët shqyrtues në raportin ekspertizës llogariten si arsyetime të panelit shqyrtues.

Andaj, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – “KK Decan”

1x1 OE ankues

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.